



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**



V E N D I M

Nr. 72, date 02.10.2018

PËR DISA KORIGJIME NË VKB NR. 54, DATË 19.07.2018 “PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E Z. GEGË LUSHI, GJIN LUSHI, ADMIR PRRONI, GEGË FUSHA, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 02.10.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2018”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme, VKB nr. 54, datë 19.7.2018, shkresës nr. 961/1 prot, datë 31.7.2018 të Prefektit të Qarkut Shkodër,

V E N D O S I :

1. Të miratojë korigjimin e pikës 9 në VKB nr. 54, datë 19.7.2018 “Për miratimin e kërkesës së bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e z. Gegë Lushi, Gjin Lushi, Admir Prroni, Gegë Fusha, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri”, si më poshtë:

Ishte :

Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 538,554 lekë (pesëqind e e tridhjetë e tetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) dhe atë në orendi, mobilje e

pajisje elektroshtëpiake në vlerën 234,820 lekë (dyqind e e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e e njëzet) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjet z. **Admir Prroni**, në total **773,374 lekë** (shatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër).

Bëhet:

Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 534,759 lekë (pesëqind e e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 234,820 lekë (dyqind e e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e e njëzet) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjet z. **Admir Prroni**, në total **769,579 lekë** (shatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë).

2. Të miratojë korigjimin e pikës 10 në VKB nr. 54, datë 19.7.2018, si më poshtë:

Ishte:

Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 305,619 lekë (treqind e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 237,620 lekë (dyqind e e tridhjetë e e shtatë mijë e e gjashtëqind e njëzet) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjet z. **Gegë Fusha**, në total **543,239 lekë** (pesëqind e dyzet e tremijë e dyqind e tridhjetë e nëntë).

Bëhet:

Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 301,162 lekë (treqind e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 237,620 lekë (dyqind e e tridhjetë e e shtatë mijë e e gjashtëqind e njëzet) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjet z. **Gegë Fusha**, në total **538,782 lekë** (pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy).

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 2.10.2018

Shpallur në datën 8.10.2018

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR

